

Në bazë të nenit 100 pika 1, 2, 3 nenit 101, 104 dhe 105 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit të Arteve, në mbledhjen e mbajtur më 18 mars të vitit 2011, miratoi

RREGULLOREN MBI STUDIMET THEMELORE-BACHELOR DHE STUDIMET PASDIPLOMIKE-MASTER NË FAKULTETIN E ARTEVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Me këtë rregullore më për së afërmi rregullohen kushtet dhe mënyra e studimit në nivelin e studimeve themelor – bachelor dhe në nivelin e studimeve pasdiplomike – master në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës.

STUDIMET THEMELORE – BACHELOR

I. KOHËZGJATJE E STUDIMEVE THEMELORE – BACHELOR DHE DREJTIMET

1. DEGA E ARTITI FIGURATIV

Neni 1

Studimet themelore – bachelor në Degën e Artit Figurativ organizohen në këto drejtime: Pikturë, Grafikë, Skulpturë, Dizajn Grafik dhe Skenografi, sipas plan programeve të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Studimet në të gjitha drejtime zgjasin katër vite respektivisht 8 semestra, pas përfundimit të cilave studime fitohen 240 ECTS kredi.

2. DEGA E ARTIT MUZIKOR

Neni 2

Studimet themelore – bachelor në Degën e Artit Muzikor organizohen në këto drejtime: Teori e muzikës, Kompozim, Dirigjim, Solokëndim, Piano, Instrumentet me harqe, Instrumente me frymë, Pedagogji e përgjithshme muzikore, Muzikologji dhe Etnomuzikologji, sipas plan programeve të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Studimet në të gjitha drejtime zgjasin katër vite respektivisht 8 semestra, pas përfundimit të cilave studime fitohen 240 ECTS kredi.

3. DEGA E ARTIT DRAMATIK

Neni 3

Studimet themelore – bachelor në Degën e Artit Dramatik organizohen në këto drejtime: Aktrim, Regji teatri, Dramaturgji dhe Regji filmi, sipas plan programeve të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Studimet në të gjitha drejtime zgjasin katër vite respektivisht 8 semestra, pas përfundimit të cilave studime fitohen 240 ECTS kredi.

II. REGJISTRIMI NË STUDIME THEMELORE - BACHELOR

1. Kuotat e regjistrimit dhe kapaciteti

Studimet në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës organizohen vetëm si studime të rregullta.

Studentët në vitin I, të studimeve regjistrohen në bazë të kuotave, të cilat i nxjerr Senati, e në propozim të Këshillit të Fakultetit.

Neni 4

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret e posaçme të organizmit, mënyrës së regjistrimit të studimeve themelore - bachelor, kohëzgjatja, organizimi dhe mënyra e përfundimit të studimeve themelore, përkatësisht hartimi i diplomës për studime themelore - bachelor në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës.

2. Konkursi për regjistrin në studime

Neni 5

Regjistrimi në studime bëhet në bazë të Konkursit të publikuar nga Rektorati i UP në bazë të Statutit.

Konkursi për studime themelore – bachelor publikohet nga Rektorati i UP sipas rregullit tre muaj, e më së paku një muaj para fillimit të procesit mësimor.

Konkursi përmban kushtet, kuotat, afatet dhe shënimet tjera të nevojshme.

3. E drejta e konkurrimit për regjistrim në studime themelore - bachelor

Neni 6.

Të drejtë pjesëmarrjen në konkurs për regjistrim në studime themelore kanë të gjithë kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm trevjeçar apo katërvjeçar dhe të cilët kanë përfunduar me sukses maturën shtetërore (kandidatët me sistem të ri të shkollimit).

Kandidatët mund të regjistrohen në më shumë drejtime në fakultet, por jo në afatin e njëjtë të regjistrimit.

Në Fakultetin e Arteve mund të regjistrohen kandidatët të cilët nuk e kanë përfunduar shkollimin e mesëm, nëse bëhet fjalë për kandidat jashtëzakonisht të talentuar, me kusht që deri në përfundim të vitit të dytë të studimeve të përfundoj shkollimin e mesëm dhe përfundon maturën shtetërore.

4. Kriteret dhe kushtet e provimit pranues

Neni 7

Përzgjedhja e kandidatëve behët sipas këtyre kriterëve:

1. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës, si dhe për kandidatët që paraqiten për pranim në Universitetin e Prishtinës e të cilët nuk e kanë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100:

- Deri 20% të pikëve mund të arrihen nga sukcesi në shkollën e mesme dhe
- Deri 80% të pikëve mund të arrihen në provimin pranues në fakultet.

2. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas suksesit dhe provimit pranues është 100:

- Deri në 20% të pikëve mund të arrihen nga sukcesi në shkollën e mesme ,
- Deri në 50% të pikëve mund të arrihen nga provimi i maturës dhe
- Deri në 30% të pikëve mund të arrihen në provimin pranues në fakultet

Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit maksimalisht me pesë pikë.

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t' i plotësojnë edhe këto kushte:

NË DEGËN E ARTIT FIGURATIV

Për përcaktimin e talentit për krijimtari artistike, kushtet e veçanta për studim në Degën e Artit Figurativ janë:

Drejtimi i Pikturës

- 5 punime të punuara sipas modelit (studimi i kokës dhe figura në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj).

Drejtimi i Skulpturës

- së paku 5 punime nga skulptura sipas modelit, prej të cilave një duhet të jetë studimi i kokës në përpjesëtime natyrore dhe së paku 5 vizatime sipas modelit.

Drejtimi i Grafikës

- së paku 5 punime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj.).

Drejtimi i Dizajnit Grafik

- së paku 5 vizatime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore), si dhe 5 punime nga dizajni grafik (ilustrime, kopertona të librit, ambalazhe etj.).

Drejtimi i Skenografisë

- 10 projekte (skenografi), skica të skenografisë për dramë të caktuar, një skenografi të inskenuar në hapësirë të caktuar.

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

- Në Drejtimin e Pikturës dhe në Drejtimin e Grafikës: vizatim i kokës sipas modelit të gjallë (2 ditë), vizatim i aktit (2 ditë) dhe pikturim i natyrës së qetë (1 ditë).

Kandidatët punojnë me material të tyre.

- Në Drejtimin e Skulpturës: modeli i kokës sipas modelit të gjallë (3 ditë), vizatim i aktit (2 ditë).

- Në Drejtimin e Dizajnit Grafik: vizatimi i kokës sipas modelit të gjallë (2 ditë), vizatimi i aktit (2 ditë) dhe dizajn grafik (2 ditë). Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohja e përdorimit të kompjuterit.

Në të gjitha drejtimet e Degës së Artit Figurativ, do të organizohet interviste gojore apo me shkrim lidhur me njohuritë mbi profesionin që do të studiojnë.

NË DEGËN E ARTIT MUZIKOR

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

Në Drejtimin e Kompozimit:

- vlerësimi i 3 kompozimeve të dorëzuara, provimi nga lëndët Solfezh, Harmonia, Polifonia dhe Pianoja.

Në drejtimet instrumentale

- provimi nga lëndët kryesore (një koncert, një sonatë dhe një pjesë e lirë për drejtimet e harkorëve dhe frymorëve, kurse për drejtimin e pianos një etidë, pjesa nga Baroku, sonatë dhe pjesë e lirë) si dhe provim nga lëndët: Solfezh dhe Teoria e muzikës.

- Në Drejtimin Perkusione provimi nga lëndët Solfezh dhe Teori e muzikës.

NË DEGËN E ARTIT DRAMATIK

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Drejtimi Aktrim:

Programi eliminues, pjesa e parë përbëhet nga:

- a) Recitim (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- b) Monolog (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- c) Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- d) Një këngë;
- e) Një imitim;
- f) Një poezi.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues përbëhet nga: puna me mësimdhënës të caktuar, hartimi i detyrës me shkrim dhe verifikimi përfundimtar i aftësive.

Drejtimi Regji Teatri Filmi

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Drejtimi Regji Filmi

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t' i shtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjirojnë vetë në temën e dhënë, film tre minutash.

Drejtimi Dramaturgj:

Hartim me shkrim në temën e lirë,

Dialogu me shkrim në temën e tragjedisë,

Dialogu me shkrim në temën e komedisë,

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga sfera e kulturës së përgjithshme,

Testim me gojë nga fusha e dramaturgjisë.

III. PROVIMET, AFATET E PROVIMEVE DHE NËNSHTRIMI I PROVIMEVE

1. Provimet

Neni 8

Provimet janë semestrare, vjetore dhe përfundimtare.

Provimet mund të jenë teorikë dhe praktikë.

Provimet teorike jepen me shkrim, me shkrim dhe me gojë. Studentë të cilët nuk e japin pjesën me shkrim të provimit nuk mund t' i nënshtrohen pjesë së provimit me gojë.

Provimet praktike jepen me punimin dhe prezantimin e punimeve.

Provimi në përgjithësi duhet të përfundoj brenda pesë ditësh.

2. Publiciteti i provimeve

Neni 9

Provimet janë të hapur për publikun.

Nëse ekzistojnë arsye studenti ka të drejtë të kërkojnë kufizimin e pjesëmarrjes së publikut.

3. Publikimi i rezultateve të provimeve

Neni 10

Mësimdhënësi duhet që studentit t'aj komunikoj rezultatit e provimit gojor menjëherë pas përfundimit të provimit, ndërsa rezultatet e provimit me shkrim më së largu në afatin prej 5 ditësh nga dita e mbajtjes së provimit, duke i publikuar rezultatet në faqen e internetit të fakultetit

4. Afatet e provimeve

Neni 11

Me Statutin e Universitetit të Prishtinës, Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit).

Periodha e saktë për çdo afat është e përcaktuar me kalendarin e përgjithshëm të studimeve, i cili është i pranuar nga Senati dhe i hapur për publikun.

Me vendimin e Senatit të UP mund të parashihen edhe afate të jashtëzakonshme të provimeve (afati i prillit dhe tetorit).

Hollësitë rreth datës së fillimit dhe përfundimit të secilit afat të provimeve janë përcaktuar nga këshillat e fakultetit.

Orari i afateve të provimeve, ku janë të përfshira orari ditorë, shpallen në fillim të vitit akademik.

Orari i provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.

Orari i provimeve, pasi të jenë shpallur, është detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin.

5. Paraqitja e provimeve

Neni 12

Koha e paraqitjes së provimit do të fillojë jo më herët se 6 javë para përfundimit dhe jo më vonë se 8 ditë para fillimit të afatit të provimit.

Orari i provimit duhet të shpallet jo më vonë se tri ditë para datës së provimit.

Nëse studenti nuk mund të hyjë në provim për shkak të një arsyeje madhore, konsiderohet që provimi është anuluar për një kohë të caktuar.

Në të gjitha rastet tjera kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet që ka dështuar (është notuar me 5).

Me kërkesë të tij, studentit mund t'i lejohej, nga dekani i njësisë akademike që të hyjë më herët në provim po qe se merr pjesë në një program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve ose është duke bërë mësimin praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim.

6. Notimi – vlerësimi dhe ankesa

Neni 13

Notimin e studentit e bënë mësimdhënësi i lëndës, ose komisioni në rast të provimit të diplomës, nota 10 (shkëlqyeshëm) 9 (shumë mirë), 8 (mirë), 7 (mjaftueshëm) dhe 6 (kënaqshëm) dhe **5 (dobët)**.

Studenti ka të drejtë të parashtojë ankesë me shkrim dekanit të fakultetit kundër notës së marrë.

Ankesa duhet të parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.

Ankesa mund të bëhet për këto arsye:

- Për provimin me shkrim – parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;
- Për provimin me gojë – parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë;
- Për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë:
 - parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim para hyrjes në provimin me gojë;
 - parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.

Pas pranimit me kohë të ankesës, dekani i fakultetit formon komisionin e provimit brenda një dite të punës pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre anëtarë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studentit.

Në rast se përsëritet provimi me gojë, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.

Në rast të ankesës kundër notës në provimin me shkrim, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.

Nuk mund të parashtrohet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Neni 14

Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.

Sipas rregullës, studentit ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.

Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të fortë, mund t'i lejohet nga dekani i fakultetit që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi pastaj mund të mbahet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët janë të emëruar nga dekani i fakultetit.

Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.

Në rast se studentit sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve.

Neni 15

Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve themelore, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).

Studenti mund të kërkojë një herë nga dekani i fakultetit për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjerë. Nëse merret vendim pozitiv studentit duhet të paguajë trefishin e tarifës së studimeve për atë periudhë.

7. Vijimi i studimeve të ndonjë viti akademik jashtë vendi

Neni 16

Studentët e Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës në kuadër të Bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit të Prishtinës me universitetet ndërkombëtare mund të vijnë në studimet e ndonjë viti akademik, dhe pas përfundimit me sukses të atij vitit akademik prapë të rikthehen për vazhdimin e studimeve në Fakultetin e Arteve.

8. Përfundimi i studimeve themelore - bachelor

Neni 17

Të gjitha programet e studimeve themelore të Degës së Artit Muzikor përfundojnë me punimin e diplomës për bachelor.

Punimi i diplomës për bachelor elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.

Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës për bachelor nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i fakultetit.

Procedura për aplikim, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për bachelor përcaktohet nga këshilli i fakultetit.

Të gjitha programet e studimeve themelore në Degën e Artit Dramatik përfundojnë me provim e fundit, në pajtim me programet e studimeve.

Të gjitha programet e studimeve themelore në Degën e Artit Figurativ përfundojnë me provim e fundit në pajtim me programet e studimeve.

9. Lejimi dhe mbrojtja e temës së studimeve themelore - bachelor

Neni 18

Studentët pas përfundimit të gjitha provimeve sipas plan programit përgatitin temën e diplomimit me propozim të profesorit të lëndës.

Pastaj studenti i drejtohet me kërkesë Këshillit të Fakultetit për lejimin e mbrojtjes së temës.

Pas mbrojtjes me sukses të temës së diplomë para komisionit të formuar nga ana e Këshillit të Fakultetit studenti përfundon studimet themelore – bachelor, dhe fiton titullin bachelor i drejtimit përkatës.

STUDIMET PASDIPLOMIKE – MASTER

IV. KOHËZGJATJE E STUDIMEVE PASDIPLOMIKE MASTER

1. DEGA E ARTITI FIGURATIV

Neni 19

Studimet pasdiplomike – master në Degën e Artit Figurativ organizohen në këto drejtime:

- Pikturë,
- Grafikë,
- Skulpturë,
- Dizajn Grafik dhe
- Skenografi,

sipas plan programeve të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Studimet në të gjitha drejtimit zgjasin **1 vit** respektivisht **2 semestra**, pas përfundimit të cilave studime fitohen **60 ECTS** kredi, ndërsa për studentët që i kanë përfunduar studimet themelore – bachelor 3 vjeçare studimet zgjasin **2 vite** pas përfundimit të cilave studime fitohen **120 ECTS** kredi.

1. DEGA E ARTIT MUZIKOR

Neni 20

Studimet pasdiplomike – master në Degën e Artit Muzikor organizohen në këto drejtime:

- Moduli artistik
 - A. Interpretim-instrumental dhe solo këndim
 - B. Kompozim
 - C. Dirigjim
- Moduli pedagogjik
 - A. Pedagogji e përgjithshme muzikore
 - B. Pedagogji instrumentale
 - C. Pedagogji e shkollimit muzikore profesional
- Moduli (shkencor) teorik /Teori e muzikës.

sipas plan programeve të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Studimet në të gjitha drejtime zgjasin **2 vite** respektivisht **4 semestra**, pas përfundimit të cilave studime fitohen **120 ECTS** kredi.

2. DEGA E ARTIT DRAMATIK

Neni 21

Studimet themelore – bachelor në Degën e Artit Dramatik organizohen në këto drejtime:

- Aktrim
- Regji Filmi
- Regji Teatri

- Dramaturgjia

sipas plan programeve të miratuara nga Këshilli i Fakultetit dhe organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.

Studimet në të gjitha drejtimit zgjasin **1.5** vite respektivisht **3** semestra, pas përfundimit të cilave studime fitohen **90** ECTS kredi, ndërsa për studentët që i kanë përfunduar studimet themelore – bachelor **3** vjeçare studimet zgjasin 2 vite pas përfundimit të cilave studime fitohen **120** ECTS kredi.

3. REGJISTRIMI NË STUDIME PASDIPLOMIKE - MASTER

1. Kuotat e regjistrimit dhe kapaciteti

Neni 22

Studimet postdiplomike të ciklit master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë studentët të cilët kanë kryer ciklin e parë të studimeve themelore (bachelor) dhe që kanë fituar së paku 180 kredi (ECTS).

Studentët të cilët gjatë ciklit të parë të studimeve kanë arritur notën mesatare 7.5 do të pranohen drejtpërdrejtë në studimet master deri te numri i paraparë.

Numri i studentëve të cilët pranohen në studimet pasdiplomike – master përcaktohet nga Rektorati i UP me propozimin e Këshillit të Fakultetit.

Rangimi i studentëve për pranim në studime master bëhet duke filluar nga nota më e lartë gjatë studimeve themelore – bachelor.

Përgjatë modulit artistik ku parashihet që kandidatët t'i nënshtrohen provimit pranues.

Studentët nën notën mesatare 7.5 do t'i nënshtrohen provimit kualifikues në të gjitha drejtimit në të cilat ata aplikojnë në studimet postdiplomike të ciklit master, në rast se nuk plotësohet numri i kërkuar me studentë të cilët e plotësojnë kriterin e notës më të lartë.

Neni 23

Studentët të cilët kanë përfunduar studimet themelore në një njësi tjetër akademike mund të konkurrojnë për studimet postdiplomike të shkallës master në Fakultetin e Arteve, për çka vendos komisioni për vlerësim i cili formohet posaçërisht për këtë qëllim.

Lëndët nga lëmi i ngushtë profesional do të caktohen nga komisioni kompetent dhe verifikohen me vendim të dekanit të Fakultetit të Arteve në bazë të propozimit të shefit të drejtimit përkatës.

Kandidatë e evidentuar duhet t'i dëgjojnë dhe t'i japin së paku pesë provime nga lëmi i ngushtë profesional para komisionit prej 3 anëtarësh. Kryetari i komisionit duhet të jetë i lëmit të ngushtë profesional.

Dëgjimi i ligjëratave për këta kandidat bëhet gjatë vitit akademik, ndërsa provimeve do t'ju nënshtrohet në qershor.

Procesverbalet e provimit të dhëna do të ratifikohen nga Senati.

Neni 24

Të drejtën e dhënies së mësimit në studimet postdiplomike të ciklit master e ka personeli mësimor në thirrje të profesorit (Profesor i rregullt, Profesor i asocuar dhe Profesor asistent) i cili i plotëson kushtet e parapara me Statutin e Universitetit të Prishtinës.

Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve në këtë cikël studimesh e kanë edhe asistentët të cilët kanë së paku titullin magjistër ose një diplomë tjetër ekuivalente.

Neni 25

Studimet postdiplomike të ciklit master zhvillohen sipas sistemit modular dhe bazohen kryesisht në lëndë të ngushta të specializimit brenda Fakultetit. Sistemi i punës në këtë cikël studimesh duhet të përfshijë edhe orët e punës praktike, përkatësisht praktikën kërkimore hulumtuese të cilën duhet ta përfundojnë studentët.

2. Sistemi i studimeve, i notimit dhe i kredive

Neni 27

Sistemi i studimeve, sistemi i notave, sistemi i kredive është i ngjashëm me studimet e ciklit të studimeve themelore - bachelor.

Neni 28

Përgjegjës për organizimin dhe sigurimin e rregullt të mësimdhënies dhe hartimin e plan programeve mësimore për studime postdiplomike të ciklit master janë: Komisioni për studime dhe prodekanët e Degëve të Fakultetit të Arteve.

3. Përfundimi i studimeve pasdiplomike - master

Neni 29

Të gjitha provimet e studimeve postdiplomike të Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës përfundojnë me punimin e diplomës për master në pajtim me programet e studimeve.

Punimi i diplomës për master elaborohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara shkencore.

Mentori tërë kohën e përcjell punën e studentit në punimin e diplomës së zgjedhur për master.

4. Përcaktimi, lejimi, vlerësimi dhe mbrotja e diplomës të studimeve pasdiplomike - master

Përcaktimi për diplomë të masterit

Studenti në bashkëpunim me mentorin përcaktohet për temën e masterit dhe i paraqet Këshillit të Fakultetit kërkesë për lejimin e temës së masterit.

Lejimi i temës së masterit

Këshillit të Fakultetit pas shqyrtimit të kërkesës merr vendim për lejimin e temës dhe emëron komisionin i cili do të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë së temës së masterit.

Tema e lejuar 15 ditë do të ekspozohet në drejtimin përkatës për t'ua mundësuar që të interesuarit ta shikojnë dhe të japin vërejtje eventuale.

Vlerësimi i temës së masterit

Pastaj komisioni pas shqyrtimit të temës së masterit për të cilën është emëruar i paraqet Këshillit të Fakultetit Raportit me shkrim pozitiv ose negativ lidhur me vlerësimin e temës së diplomës të studimeve pasdiplomike-master.

Mbrojtja e temës së masterit

Pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit për vlerësimin e përshtatshmërisë së temës së studimeve pasdiplomike - master, Këshillit formon Komisionin për mbrojtjen e temës së masterit dhe përcakton ditën e mbrojtjes.

Pas mbrojtjes me sukses të temës së studimeve pasdiplomike – master studenti përfundon studimet master dhe fiton titullin master i drejtimit përkatës.

Neni 30

Të gjitha njësitë drejtimit të cilat organizojnë studime postdiplomike (cikli Master) janë të detyruara që të dorëzojnë planet dhe programet mësimore më së voni tre muaj para fillimit të realizimit të programit.

Degët mund të organizojnë programe interdisciplinare të studimeve pasdiplomike të ciklit master.

Degët në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit mund të organizojnë studime postdiplomike të ciklit master më njësi akademike përkatësisht fakultete të universiteve ndërkombëtare.

Neni 31

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Prishtinë, 18.3.2011

DEKANI

Mr. Art. Adem Rusinovci, prof. i asocuar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I ARTEVE



RREGULLORJA MBI STUDIMET THEMELORE-BACHELOR DHE STUDIMET PASDIPLOMIKE-MASTER

Prishtinë, 2011

PËRMBAJTJA

REGULLOREN MBI STUDIMET THEMELORE-BACHELOR DHE STUDIMET PASDIPLOMIKE-MASTER NË FAKULTETIN E ARTEVE	1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	1
STUDIMET THEMELORE – BACHELOR.....	1
I. KOHËZGJATJE E STUDIMEVE THEMELORE – BACHELOR DHE DREJTIMET	1
1. DEGA E ARTITI FIGURATIV	1
2. DEGA E ARTIT MUZIKOR.....	1
3. DEGA E ARTIT DRAMATIK.....	2
I. REGJISTRIMI NË STUDIME THEMELORE - BACHELOR	2
1. Kuotat e regjistrimit dhe kapaciteti	2
2. Konkursi për regjistrin në studime.....	2
3. E drejta e konkurimit për regjistrim në studime themelore - bachelor	2
4. Kriteret dhe kushtet e provimit pranues.....	3
II. PROVIMET, AFATET E PROVIMEVE DHE NËNSHTRIMI I PROVIMEVE.....	5
1. Provimet.....	5
2. Publiciteti i provimeve.....	5
3. Publikimi i rezultateve të provimeve	6
4. Afatet e provimeve.....	6
5. Paraqitja e provimeve	6
6. Notimi – vlerësimi dhe ankesa.....	7
7. Vijimi i studimeve të ndonjë viti akademik jashtë vendi.....	8
8. Përfundimi i studimeve themelore - bachelor	8
9. Lejimi dhe mbrojtja e temës së studimeve themelore - bachelor.....	8
STUDIMET PASDIPLOMIKE – MASTER.....	9
III. KOHËZGJATJE E STUDIMEVE PASDIPLOMIKE MASTER	9
3. REGJISTRIMI NË STUDIME PASDIPLOMIKE - MASTER	10
1. Kuotat e regjistrimit dhe kapaciteti.....	10
2. Sistemi i studimeve, i notimit dhe i kredive.....	11
3. Përfundimi i studimeve pasdiplomike - master.....	11
4. Përcaktimi, lejimi, vlerësimi dhe mbrojtja e diplomës të studimeve pasdiplomike - master. 11	
Përcaktimi për diplomë të masterit	11
Lejimi i temës së masterit	11
Vlerësimi i temës së masterit	12
Mbrojtja e temës së masterit	12